

SHIKO DHE VEPRO

Fëmijë të shëndoshë në Shkollën Erzbachtal-it

Informata për prindër

Të dashur prindë

Shkolla e Erzbachtal-it dëshiron që t'i nxis fëmijët sa të jetë e mundur, që të kontribuojnë për zhvillimin e tyre të shëndetshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore të marrin përgjegjësi*. Nëse paraqiten pengesa dhe vështirësi, ne përpiqemi t'i gjemë shkaqet e problemeve dhe të reagojmë duke iu ofruar ndihmë.

Për këtë ne marrim pjesë në projektin „Shiko dhe Vepro“. Parimi i këtij koncepti do të aplikohet në të gjitha nivelet e shkollës sonë. Ai i ndihmon mësuesit që të gjitha anomalitë t'i njohin në një shkallë më të hershme, të gjykojnë drejtë dhe të ndërmarrin hapa për përmirësimin e situatës. Në varësi me vështirësinë, biseda është mënyrë e drejtë, por do të ndihmonte edhe angazhimi i një këshillimoreje, si dhe marrja e masave disiplinore. Gjithnjë vlenë parimi: **Ne shohim te problemet dhe veprimet.**

Ne dëshirojmë që fëmijën dhe juve si prindë që në fillim t'u përfshijmë në procesin e zgjidhjes. Iniciativa për bisedë natyrisht mund të vije edhe nga ju. Shfrytëzoheni mundësinë për të folur haptas për vështirësitë, për ta sjellur pikëpamjen tuaj dhe nëse është e nevojshme për të kërkuar edhe ndihmë.

Mësuesit dhe personat tjerë profesionistë i nënshtrohen ruajtjes së fshehtësisë së bisedës dhe vetëm pas bisedës me juve, japin informata që janë në shërbim të zhvillimit të shëndetshëm të fëmijës tuaj.

Ne gëzohemi për bashkëpunim të mirë me juve si prindër. Nëse ju keni ndonjë pyetje, drejtohuni me plot besim te mësuesi i fëmijë suaj ose në Shërbimin Social Shkollor. Ata me kënaqësi do t'u këshillojnë.

Drejtoria e Shkollës Erzbachtal

*Neni për mbrojtjen e fëmijëve i Ligjit Civil Zviceran bazohet në Konventën e OKB-së për fëmijë. Ky nen deri në prill të vitit 2010 është nënshkruar nga 193 shtete dhe fëmijëve tonë iu jep të drejtë për mirëqenie trupore dhe mendore. Kështu prindërit kanë detyrë për t'i edukuar fëmijët në bazë të rrethanave të tyre, zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe moral t'a nxisin, promovojnë dhe mbrojnë (Ligji Civil Zviceran, neni 302, al. 1). Shkolla është e obliguar të veprojë nëse ka njohuri për rrezikimin e fëmijës (Ligji Civil Zviceran, Hyrje në Ligjin Civil Zviceran, neni 55, al. 2).

www.unicef.de/information/kinderrechte